

# STATUTI

I

## SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "FAST INTERNATIONAL CONSULTING" SH.P.K.

Ne këtë statut:

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë "FAST INTERNATIONAL CONSULTING" sh.p.k.

### KREU I

**Themelimi – Emri – Objekti – Kohëzgjatja – Selia**

#### **Neni 1 - Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

1. Sot, më datë 21/02/2017, ne, themeluesit, kami krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "**FAST INTERNATIONAL CONSULTING**" SH.P.K..
2. Themeluesit e shoqërisë janë:
  - **Z. Giovanni Faggiano**, lindur më 24/04/1959, në Brindisi, rezident në adresën Piazza del Popolo 1, 72100, Brindisi, Italia.
  - **Z. Antonio Stabile**, lindur më 11/09/1975, në San Pietro Vernotico, Brindisi, rezident në San Pietro Vernotico, Brindisi, adresa Via Pier Della Francesca, 11, Italia.

#### **Neni 2 – Objekti**

- 1 Shoqëria ka si objekt zhvillimin, e drejtpërdrejtë dhe/ose nëpërmjet shoqërive me "pjesëmarrje" ose të "kontrolluara", e veprimtarive në vijim:
  - Projektimin dhe realizimin e Ndërtesave Civile, Turistike dhe Industriale;
  - Projektimin dhe realizimin e impianteve teknologjike civile, industriale dhe mjedisi;
  - Projektimin, realizimin dhe menaxhimin e impianteve për trajtimin e mbetjeve urbane, landfildje, mbledhjen e mbeturinave;
  - Konsulencë dhe asistencë për Certifikime Cilesie të çdo lloji;
  - Konsulencë dhe Asistencë Ligjore për Shoqëritë dhe Industrinë;
  - Import/Eksport i Produkteve Agrorëshqimore;



- Import/Eksport i Produkteve Industriale;
- Konsulencë per Sigurimin;
- Konsulencë Imobiliare;
- Dhënien e sherbimeve te finalizuara ne fushën e informacionit te biznesit;
- Realizimin dhe menaxhimine e sistemeve te klasifikimeve "Rating" & "Scoring" dhe cdo sistem tjetër per vleresimin e riskut te kreditimit; Realizimin e studimeve dhe kerkimeve ne pozicionimin konkureses te siperarrjeve, te bazuara ne strukturat dhe ne prospektivat e sektorve ekonomik dhe te zonave gjeografike kombetare dhe nderkombetare;
- Furnizimin e sherbimeve te vleresimit, per llogari te vet dhe per te trete, te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, materiale dhe jomateriale per qellime sigurimi, bankare, menaxhuese dhe tregtare. Me kete qellim shoqeria mund:
  - Te marre mandate, edhe nepermjet nje rrjeti te vet bashkepuntoresh ose duke iu besuar keto mandate subjekteve te treta te kualifikuar, ne lidhje me menaxhimin dhe kryerjen e studimeve të fizibilitetit, kerkimeve, indekseve, perpunimin e te dhenave, konsulenca dhe ekspertiza;
  - Te zhvilloje veprimtari supervizimi dhe kontrolli te nje ekzekutimi te sakte, te menaxhimit dhe koordinimit te veprimtarive te mesiperme;
- konsulence ndermarjesh, teknike dhe organizative, marketingu, kerkime tregu, perpilime dhe ndermjetesime kontratash, projektme dhe implementime ne sektorin e sherbimeve, te pasurive te paluajtshme dhe tregtare;
- organizim dhe asistence organizimi, duke perfshire asistence prite nepermjet "hostess" dhe "stewart", siguri ne grumbullimet dhe shperndarjet masive, furnizimin e stafit zjarfikes dhe te nderhyrjes se shpejte, te kongreseve, te mbledhjeve, te conferencave, te manifestiveve, te eventeve muzikore, te eventeve sportive, festave ne sheshe, koncerte, sfilata dhe show-room ne lokale publike dhe private, dhe kryesisht fushata promovuese per llogari te vet dhe per te trete;
- furnizimi dhe mirembajtja e impianteve dhe komponentet e sistemeve te sigurise aktive dhe pasive, aparate teknologjike elektronike dhe telefonike ne lidhje me mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurive te luajtshme, te paluajtshme dhe te sigurise ne përgjithësi;
- sherbime të ruajtjes ne besim që kanë të bëjnë me sigurine, dorëzimin e dokumentave edhe të rezervuara, dhenien edhe gjatë natës të mjeteve te emergjences;
- menaxhimin e centralizuar dhe optimizimin e integruar të sherbimeve te mbikëqyrjes, si edhe sigurine për llogari të të tretëve, duke ndjekur dhe plotësuar të gjitha funksionet e nevojshme, ne lidhje me shërbimet e mësipërme;
- parashikimin e zgjidhjeve më të mira në fushën e sigurisë së plotë, si në nivel kombëtar ashtu edhe ne atë ndërkombëtar me studime relative, kerkime dhe vlerësime risku, si dhe realizimin e metodologjive dhe

teknikave më të mira për vetëmbrojtjen, tutelen dhe mbrojtje e aseteve të sipërmarrjes, personale, sociale, fizike dhe ambientale;

- studime, projektme e fizibilitete të sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e informacionit, te telekomunikimit elektronik, te informatikes dhe telematikës;
- planifikime, programime dhe organizime siminaresh, kurse, stazhe per formimin dhe rikualifikimin e stafit për sigurinë e plotë, si edhe kërkim dhe perzgjedhje personeli për llogari të sipërmarrjeve ashtu edhe për privatë;
- organizimin dhe menaxhimin e shërbimeve të sigurisë, në vende publike dhe private, kongrese, manifestime panairesh dhe pritje;
- themelimin, organizimin dhe menaxhimin e kurseve të specializuara per formimin e stafit zjarfikës, stafit të sigurisë, stafit të ndërhyrjes së shpejtë duke përdorur dhe defribilatorin;
- shërbime të investigimit privat, mbledhja e informacioneve tregtare, kërkimin e personave dhe të sendeve, shërbime dhe konsulenca për hetime penale dhe gjyqësore ose hetime për institutet e sigurimeve ose hetime mbi mjetet dhe burimet e provave;

2 Shoqëria mund të kryejë veprimtarit e tjera te mëposhtme:

- veprimtari komunikimi dhe marrëdhënie publike, duke përfshirë menaxhimin e zyrave per shtyp, televizione, radio, gazeta (te perditshme eskluzive), revista;
- asistence per delegacionet brenda dhe jashte vendit per motive biznesi, studimi, kulturore, politike, shkencore, etj.;
- shërbime arsimimi dhe trajnime profesionale ne lidhje me projekte, kurse dhe konsulenca orientimi dhe parandalimi qe kane te bejne me psikologjine dhe pedagogjine ne pergjithesi;
- veprimtari qe lidhen me menaxhimin e "call-center";
- kerkime, seleksionime dhe menaxhim personeli per llogari te te treteve;
- organizime, menaxhime dhe supervizime te kurseve te formimit profesional dhe te azhornimeve;
- mirembajtje, instalime dhe riparime te ndryshme per pallate banimi dhe sipërmarrje ne pergjithesi;

3 Per arritjen e qellimit social, shoqeria mund te kryeje cdo lloj transaksioni industrial, tregtar, pasuri te luajshme dhe pasuri te paluajshme.

4 Shoqeria ushtron veprimtarite dhe shërbimet e veta ne temat e cilesise, te ambientit, te sigurise, te etikes dhe te vleresimit te produktit kombetar, evropian dhe nderkombetar. Veprimtarite dhe shërbimet i perkasin kryesisht sektorit agroushqimor, turizmit, artizanatit, ambientit, artit dhe tradicionit. Veprimtarite dhe shërbimet iu drejtohen sipërmarrjeve, enteve publike dhe private kombetare dhe nderkombetare.

5 Shoqeria, nepermjet Organit administrativ, mund te marre kredi dhe financime, te jape garanci, edhe reale, te zhvilloje veprimtari financiare "jo kundrejt publikut" dhe te marre kuota dhe perqindje ne sipërmarrje te tjera, me qellim realizimin dhe permbushjen e objektit social.



- 6 Te gjitha keto veprimtari duhte te zhvillohen ne limitet dhe ne respekt te normave qe disiplinohen ushtrimin e tyre dhe konform normave te percaktuara nga ligji.

### Neni 3 – Selia

- 1 Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresën: Rr. “Hajdar Hidi”, Pall. 4, Kati 4, Tirane, Shqipëri.
- 2 Adresa e postes elektronike e shoqërisë “FAST INTERNATIONAL CONSULTING” sh.p.k. për qëllime komunikimi është si vijon: **internationalfast.ltd@gmail.com**.
- 3 Shoqëria ka te drejte te hape dhe te mbylle dege, filiale, agjenci dhe zyra përfaqësie ne vende te tjera te Shqipërisë dhe jashtë saj, ose te ndryshojë adresën (rrugën dhe numrin) e selisë qendrore brenda dhe jashtë territorit te Bashkisë se lartpërmendur.
- 4 Vendbanimi i ortakeve dhe te organeve drejtuese, për marrëdhëniet e tyre me shoqërinë, është ai qe rezulton nga regjistrin e ortakeve, është detyre e ortakeve dhe te antareve te organeve drejtuese, ti komunikojnë shoqërisë, me qellim transkriptimin ne regjistrin e ortakeve, edhe numrin e fax-it dhe adresën e postes elektronike, kështu qe mund te përdoren ne funksion te tyre si forma komunikimi.

### Neni 4 – Kohëzgjatja

- 1 Kohëzgjatja e shoqërisë është caktuar deri më 31 dhjetor 2067 me të drejtë rinovimi automatikisht me 10 vjet me përjashtim kur asambleja e ortakëve parashikon ndryshe.

## KREU II

### Kapitali

#### Neni 5 - Kapitali Themeltar

- 2 Kapitali themeltar i shoqërisë “FAST INTERNATIONAL CONSULTING” Sh.p.k. është **1.400.000,00 Lekë (Njemilion e katerqind mijë/00)** i ndare ne **2 (dy) kuota**. Pjesëmarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqërisë është ne përputhje me kontributet e tyre te mëposhtme:
  - Ortaku themelues **Z. Giovanni Faggiano**: Zotërues i **1 (një)** kuote me vlere te përgjithshme **700.000,00 Lekë (Shtatëqind mijë/00)** qe përben **50% (pesëdhjet për qind)** te kapitalit;
  - Ortaku themelues **Z. Antonio Stabile**: Zotërues i **1 (një)** kuote me vlere te përgjithshme **700.000,00 Lekë (shtatëqind mijë/00)** qe përben **50% (pesëdhjet për qind)** te kapitalit.

#### Neni 6 - Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

1. Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve te pjesëve te kapitalit themeltar për kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre,



Ortakët vlerësojnë kontributet në natyrë në marrëveshje të ndërsjellta me njëri-tjetrin dhe i shprehin vlerat e tyre në para. Nëse nuk mund të arrihet një marrëveshje, secili prej ortakëve mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse, për të ngarkuar një ekspert vlerësues, me një vendim me efekt detyrues. Raporti i ortakëve ose i ekspertit për vlerësimin e kontributeve i dorëzohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me të dhënat e tjera të kërkuara për regjistrim.

2. Ortaket mund të kryejnë, me kërkesë të organit administrativ, financime, edhe jo në proporcion të pjesëmarrjes përkatëse në kapitalin e shoqërisë, pa detyrim kthimi ose me detyrim kthimi, me pagese ose pa pagesë, në respekt të kushteve e të limiteve të përcaktuar nga ligji për mbledhjen e të ardhurave.
3. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
4. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asamblëja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkojnë për ndryshimin e statutit.
5. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortaket në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### Neni 7 - Transferimi i Kapitalit

1. Kuotat transferohen lirisht midis Ortakëve.
2. Transferimi i Pjesëve të Kapitalit tek të tretet janë objekt i të Drejtës së Parablerjes në favor të Ortakëve të tjerë, të cilët mund ta ushtrojnë këtë të drejtë sipas procedurave të specifikuar në nenet e mëposhtme.
3. Në rast se një ortak ("Ofruesi") kërkon të shesë dhe /ose të transferojë disa ose të gjitha kuotat e tij tek një pale e trete, ortaket e mbetur (Ortakët e Mbetur") kanë të drejtën e parablerjes në lidhje me Kuotat e propozuara për transferim ("Kuotat e Ofruara"), sipas termave dhe kushteve të mëposhtëm:
  - a. Ofruesi do t'u dërgojë fillimisht një njoftimi me shkrim Ortakëve të Mbetur duke përcaktuar numrin dhe çmimin e Kuotave të Ofruara, në kushtet e tjera material të transferimit ("Oferta"), duke ftuar se pari Ortaket e Mbetur për blerjen e këtyre Kuotave;
  - b. Ortaket e Mbetur kanë të drejtë të blejnë Kuotat e Ofruara sipas kushteve të Ofertës, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Ofruesit, brenda një afati prej 30 (tridhjet) ditësh pas marrjes së njoftimit të Ofruesit.
4. Në rast se Ortaku i Mbetur ka refuzuar blerjen e Kuotave të Ofruara ose nuk është përgjigjur në lidhje me blerjen e Kuotave të Ofruara, sipas kushteve të përcaktuara në Ofertë, Ofruesi ka të drejtën t'i transferojë Kuotat e Ofruara një pale të trete sipas kushteve të Ofertës fillestare. Çdo transferim i Kuotave të Ofruara tek një pale e trete me kushte të tjera nga ato të Ofertës Fillestare është absolutisht i pavlefshëm dhe nuk sjell asnjë efekt.
5. Në rast se Ortaku i Mbetur blen Kuotat e Ofruara, ky transferim do të kryhet në përputhje me kushtet e Ofertës, përveç në rast të një marrëveshjeje tjetër midis Ortakëve.
6. Në rast se Ortaku i Mbetur nuk blen Kuotat e Ofruara brenda një afati 30 ditor duke filluar nga njoftimi i tij në përputhje me nenin 7.4, atëherë Ofruesi ka të drejtën t'i

transferoje Kuotat e Ofruara një pale te trete sipas kushteve te Ofertës fillestare.

7. Çështjet e mësipërme nuk do te zbatohen për transferimet nga një Ortak tek një shoqëri e kontrolluar prej tij (te paktën ne masën 51% te kapitalit), ose një transferim nga një Ortak tek një paraardhës apo pasardhës te drejte për drejte te tij, apo tek bashkëshorti/ja.
8. Te gjitha njoftimet e përcaktuara ne ketë nen duhet ti adresohen edhe shoqërisë.
9. Çdo transferim apo zotërim i Kuotave, ashtu si dhe krijimi apo transferimi i çdo te drejte tjetër mbi to, duhet te regjistrohen ne regjistrin e Ortakeve dhe ne QKR

### KREU III

### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8 - Organi Vendimmarrës**

1. Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë.
2. Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te përcaktuara ne ligj.
3. Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a. përcaktimin e politikave tregtare te shoqërisë;
  - b. ndryshimin e statutit;
  - c. emërimin e shkarkimin e administratoreve;
  - d. emërimin e shkarkimin te likuiduesve dhe te eksperteve kontabël te autorizuar;
  - e. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur ne shkronjat "c" dhe "d" te kësaj pike;
  - f. mbikëqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë;
  - g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë;
  - h. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j. përfaqësimin e shoqërisë ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
  - k. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - l. miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblesë;



- m. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo nga ky statut.
4. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
  5. Administratoret e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakeve në asamblenë e përgjithshme.
  6. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 9 - Mënyrat e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

1. Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratoret sa here që është e nevojshme për interesat e Shoqërisë dhe sa here kërkohet nga ligji i zbatueshëm.
2. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë, me letër rekomande apo me postë elektronike dërguar ortakeve, në adresën e përcaktuar në regjistrin e ortakeve ose në adresën elektronike të ortakeve, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara ditës së caktuar të mbledhjes.
3. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 9.2 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendim, pavarësisht parregullsisë së mbledhjes.

#### **Neni 10 – Kuorumi**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30 % (tridhjet) të kuotave.
2. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
3. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 11 - Marrja e vendimeve**

1. Asambleja e përgjithshme vendos me  $\frac{3}{4}$  (tre/katër) e votave të zotëruesve të kapitalit të ortakeve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakeve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:
  - a. përcaktimin e politikave tregtare, planeve të biznesit dhe buxhetit;
  - b. emërtimin dhe shkarkimin e Administratorit(eve);



- c. emërtimin dhe shkarkimin e Eksperteve Kontabël dhe Likuiduesve;
  - d. përcaktimin e shpërblimeve;
  - e. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - f. përfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;
  - g. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.
3. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

### Neni 12 - Përjashtimi nga e drejta e votes

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a. vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b. shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c. ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d. dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jete në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### Neni 13 – Administrimi

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizik si administratore të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 (pese) vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit "QKR".
2. Administratoret e një shoqërie tregtare mëme, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji nuk mund të emërohen si administratore të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
3. Personi i mëposhtëm caktohet si administrator i parë i shoqërisë për një periudhë 5 (pese) vjetecare duke filluar nga data e themelimit të shoqërisë.
4. Të dhënat e identifikimit: Specimenti e nënshkrimi
  - **Z. Mariglen Bardho** \_\_\_\_\_
  - Adresa: Rr. Naim Frasheri, Pall. 63, Tirane.

### Neni 14 - Kompetencat e Administratoreve

1. Administratoret kanë të drejtë e detyrohen të:





- a. kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b. përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c. kujdesen për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d. përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet dhe shpërndarjen e fitimeve, të paraqisin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - g. raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - h. kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e përgjithshme, në rastet kur:
- a. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
  - b. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë me të lartë se 5 % (pese) të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
3. Nëse asambleja e përgjithshme emëron me shume se një administrator, ata e administrojnë shoqërinë në mënyrë të pavarur nga njëri tjetri.
4. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padite që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### **Neni 15 - Përgjegjësitë e Administratorit**

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretave, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
2. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dem shoqërisë i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen për të përballuar në mënyrë individuale ose solidare sipas rastit pasojat përkatëse.
3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17, 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë

Tregtare" administratori detyrohet:

- a. Te kryeje detyrat e tij te përcaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirëbesim e ne interesin me te mire te shoqërisë ne tërësi, duke i kushtuar vëmendje te veçante ndikimit te veprimtarisë se shoqërisë ne mjedis;
  - b. Te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetëm për arritjen e qëllimeve te përcaktuara ne këto dispozita;
  - c. Te vlerësoje me përgjegjësi çështjet, për te cilat merret vendim;
  - d. Te parandaloje dhe mënjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshëm, te interesave personale me ata te shoqërisë;
  - e. Te ushtroje detyrat e tij me profesionalizimin dhe kujdesin e nevojshëm.
4. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne mënyre te arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vlerësimit te informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer ne mirëbesim.
5. Nëse administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 dhe 2 te këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërbleje shoqërisë demet qe rrjedhin nga kryerjet e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga këto veprime te parregullta. Administratori ka barrën e provës për te vërtetuar kryerjen e detyrave te tyre ne mënyre te rregullt e sipas standardeve te kërkuara. Kur shkelja është kryer nga me shume se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë ne mënyre solidare.
6. Ne mënyre te veçante, por pa u kufizuar ne to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërbleje shoqërisë demet e shkaktuar, nëse, ne kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" kryhen veprimet e mëposhtme:
- a. u kthen ortakeve kontributet;
  - b. u paguan ortakeve interesa apo dividendë;
  - c. u shpërndan aktivet e shoqërisë;
  - d. lejon qe shoqëria te vazhdoje veprimtarinë tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikojë qe shoqëria nuk do te kishte aftësi paguese për te shlyer detyrimet;
  - e. jep kredi.
7. Përveç padisë për shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrenë padi penale kundër administratorit.
8. Paditësit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i është shkaktuar shoqërisë, përfshire dhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund te ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyrës.

**KREU IV**



## VITI FINANCIAR – EKSPERTET

### Neni 16 - Viti financiar

1. Viti financiar i shoqërisë fillon ne datën e pare te muajit Janar dhe përfundon ne ditën 31-te te muajit Dhjetor te secilit vit. Viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor te po atij viti.

### Neni 17 – EKSPERTET

1. Eksperti ka për detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabël te veprimtarisë ekonomiko tregtare te shoqërisë, atë gjithëvjetorë dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
2. Ne përfundim te kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike te ushtruara, te cilat është i detyruar qe t'ja paraqesë e dorëzoje ne kohe ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën te drejtës vendimore qe ka.

## KREU V

### PRISHJA - RIORGANIZIMI I SHOQERISE

#### NENI 18 - PRISHJA DHE LIKUJDIMI

1. Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund te behet ne çdo kohe kur:
  - a. mbaron kohëzgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
  - b. me vendim te Asamblesë se Ortakeve;
  - c. me hapjen e procedurave te falimentimit;
  - d. nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarisë ne përputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit";
  - e. me vendim te gjykatës.
2. Ne ketë rast ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilën parashikojnë mënyrën e likuidimit te shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument te nxjerre pre tij merin e likuidatorit dhe emërtesën shtese "Shoqëri ne likuidim e sipër".
3. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim te rasteve kur është nisur një procedure falimentimi.
4. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.



5. Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **Neni 19 - Riorganizimi i Shoqërisë Bashkimi-Ndarja**

1. Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së përgjithshme të Asamblesë së Ortakeve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

#### **Neni 20 - Baza Ligjore**


1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.
2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 21 - Mosmarrëveshjet**

1. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

### **ORTAKET**

**Giovanni Faggiano**



**Antonio Stabile**



Cognome..... **STABILE**  
 Nome..... **ANTONIO**  
 nato il..... **11/09/1975**  
 (atto n. .... **720** ..... I S. A. 1975)  
 a..... **SAN PIETRO VERNOTICO (BR)**  
 Cittadinanza..... **ITALIANA**  
 Residenza..... **SAN PIETRO VERNOTICO**  
 Via..... **DELLA FRANCESCA PIERO N. 31**  
 Stato civile..... **CONIUGATO**  
 Professione..... **IMPRENDITORE**  
 CONNOTATI E CONTRASSEGNI SALIENTI  
 Statura..... **m. 1,70**  
 Capelli..... **CALVO**  
 Occhi..... **CASTANI**  
 Segni particolari..... **NESSUNO**

Firma del titolare..... *Antonio Stabile*  
**SAN PIETRO VERNOTICO** 18/09/2012  
 Impronta del dito indice sinistro.....  
 Il SINDACO.....  
 D'ORDINE DEL SINDACO.....  
 L'IMPIEGATO ADDETTO (Massimo DELUCA)  
*Massimo Deluca*




TESSERA EUROPEA DI ASSICURAZIONE MALATTIA

2022/50/90

10005 - 500001

STBNTN19X X111119X

80380001600102819807

STABILE

ANTONIO




*Antonio Stabile*

REPUBBLICA ITALIANA  
**TESSERA SANITARIA**  
 CARTA REGIONALE DEI SERVIZI

Codice Fiscale: **STBNTN75P111119X** Sesso: **M**

Cognome: **STABILE** Nome: **ANTONIO**

Luogo di nascita: **SAN PIETRO VERNOTICO**

Provincia: **BR**

Data di nascita: **16/11/60**

Data di scadenza: **06/50/90**

2014

*Antonio Stabile*

REPUBBLICA ITALIANA  
 COMUNE DI  
 SAN PIETRO VERNOTICO  
**CARTA D'IDENTITÀ**  
 N° AT 4495537  
 DI  
 STABILE ANTONIO

Scade il 11/09/2022  
 Diritti segg. C.I. 0,65  
 5,16

AT 4495537

IPZS spa - OFFICINA CV - ROMA





*Faggiano*